



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

AD/GJTHFR.nr.8/2023

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese A.K., avokat nga Prishtina, me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj S.K., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 24 gusht 2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj S.K., e paraqitur nga pala ankuese A.K., avokat nga Prishtina, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 7 gusht 2023, përmes postës ka pranuar ankesën e palës ankuese A.K., avokat nga Prishtina (tutje ankuesi), me pretendimin për shkelje disiplinore nga neni 5 par.2.2 lidhur me par 1 nënpar 1.3 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndaj gjyqtarit S.K., i cili sipas ankuesit Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda me datë 4 korrik 2023, pranë

Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda ka dorëzuar kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit nda të pandehurit I.V. në drejtim të dyshimit të bazuar për veprat penale fajde nga neni 331 par.3 të KPRK-së dhe veprës penale shmangie nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së, për të cilën kërkesë me datë 5 korrik 2023 pranë kësaj gjykatë është mbajtur seanca dëgjimore për trajtimin e kërkesës së prokurorisë. Ankuesi ka theksuar se në faqen e fundit të kërkesës për caktimin e masës së paraburgimit, prokuroria kishte listuar një sërë provash personale dhe materiale, të cilat sipas saj ndërlidheshin me çështjen e të mbrojturit të tij, ndërsa nga ana e gjykatës ishin pajisur vetëm me kërkesën e prokurorisë pa i bashkangjitur asnjërën nga provat përcjellëse. Edhe përkundër që në cilësi të mbrojtësit kishim kërkuar nga gjykata që së bashku me kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit të pajisemi edhe me provat përcjellëse, ashtu që karshi tyre të përgatisim mbrojtjen sipas detyrës që kemi, një kërkesë e tillë na u është refuzuar nga kjo gjykatë duke e privuar të pandehurin nga mbrojtja në interesin e tij.

Gjithashtu ka theksuar se gjyqtari S.K., në njërin prej rasteve që kohëve të fundit kishte marrë përmasa publike – seancë dëgjimore e karakterit të njëjtë, e kishte zgjatur për afërsisht 9 (nëntë) orë, duke e liruar të pandehurin në procedurë të rregullt (i cili ishte i dyshuar për tri vepra penale, përkundër të gjithë të bashkëpandehurve të tjerë të cilëve u kishte caktuar masën e paraburgimit edhe pse të njëjtit ishin të dyshuar për vetëm një vepër penale), të cilin gjithashtu e kishte pajisur me të gjitha shkresat e lëndës. Përkundër kësaj, në rastin konkret, i njëjti gjyqtar seancën dëgjimore në fjalë arrin ta përfundojë për afërsisht 1 (një) orë dhe pa e pajisur mbrojtjen me provat të cilat mëtonin të mbështesnin dyshimin e bazuar mirë të pretenduar nga ana e Prokurorisë për t'ia caktuar të njëjtën masë të paraburgimit. Dhe si përfundim ankuesi ka theksuar se veprimet e tilla të gjyqtarit paraqesin diskriminim dhe trajtim jo të drejtë të pandehurit në procedurë e cila zhvillohet ndaj tij, dhe konsistojnë në shkelje sipas dispozitës së nenit 5 paragrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 nënpar 1.3 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore.

Gjyqtari e ngarkuar me këtë çështje S.K., në deklaratën e tij me shkrim dërguar përmes e-mailit lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se pretendimet e mbrojtësit të pandehurit I.V., av.A.K. janë krejtësisht të pabazuara duke i arsyetuar si në vijim:

- Para fillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj për caktimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurit I.V., mbrojtësit të pandehurit i është

dorëzuar kërkesa e prokurorit të shtetit për caktimin e masës së paraburgimi, nga ana ime si gjyqtar i procedurës paraprake me qëllim të përgatitjes së tij për seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore është mbajtur me datë 05.07.2023 duke filluar në ora 10:00, ku prezent kanë qenë prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, av.A.K., dhe pasi që është konstatuar prezenca e palëve në procedurë dhe është konstatuar se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës dëgjimore, prokurori i shtetit e ka elaboruar kërkesën e tij për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit, pastaj fjalën ja kam dhënë mbrojtësit të pandehurit, av.A.K. për tu deklaruar lidhur me kërkesën e prokurorit të shtetit dhe i njëjti siç është shënuar në procesverbalin e seancës dëgjimore në faqe 6 të procesverbalit (*është shënuar para se të filloj ekspozen apo shtjellimin tim kërkoj nga gjykata që të më dorëzohen provat të cilat janë të cekura në shtojcën e kërkesës për caktimin e masës së paraburgimit*), ka kërkuar nga gjyqtari i procedurës paraprake që të ia dorëzoj shkresat e lëndës që janë të listuara në fund të kërkesës së prokurorit, dhe unë në atë rast së pari kam marrë mendimin e prokurorit të shtetit, i cili ka theksuar se *“në këtë fazë të procedurës penale mbrojtësit të të pandehurit nuk mund të i dorëzohen provat e kërkuara pasi që në dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve ka të dhëna konfidenciale edhe për të pandehurit tjerë, kurse provat materiale që i referohen këtij të pandehuri prokurori është zotuar se do të ia dorëzon në një fazë më të përshtatshme të procedurës penale, duke shtuar se avokati ka pasur rast që të i shikoj provat por jo edhe ti i fotokopjoj dhe ti merr fizikisht”*, andaj si gjyqtar i procedurës paraprake pasi kam marrë mendimin e prokurorit të shtetit, për tu mos u dëmtuar ky proces hetimor kam refuzuar kërkesën e avokatit që ti merr kopjet fizike të këtyre provave.

Në këtë rast mbrojtësi të gjitha provat ka mundur ti kërkoj dhe ti siguroj me kohë konform nenit 209 par.2,3,4,5,6 dhe 7 të KPP-së nga prokurori i shtetit, e në rast të refuzimit nga ana e prokurorit atëherë ka mundur të ankohet te gjyqtari i procedurës paraprake. Duke shtuar se gjatë seancave dëgjimore mbrojtësit parashtrajnë propozime të ndryshme, por nuk do të thotë se çdo propozim i palëve duhet të aprovohet, andaj gjyqtari ka theksuar këtë pretendim ankuesi ka munduar ta parashtron edhe në ankesën e drejtuar Gjykatës së Apelit të Kosovës ndaj aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit, dhe kjo gjykatë do ta trajtonte në rast se do të kishte konstatuar shkelje e njëjta do ta anulonte vendimin, mirëpo gjyqtari ka njoftuar se Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin PN1.nr.802/2003 të datës 27.07.2023, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit dhe e ka vërtetuar aktvendimin për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit I.V.

- Sa i përket pretendimit tjetër të ankuesit se në njërin prej rasteve të fundit që ka marrë përmasa publike dhe seanca ka zgjatur për 9 (nëntë) orë, duke e liruar të pandehurin e dyshuar për tri vepra penale në procedurë të rregullt, e të cilin e kishte pajisur me të gjitha shkresat e lëndës, kurse të pandehurit tjerë të dyshuar për nga një veprë penale u ka caktuar masën e paraburgimit, sa për informim të kësaj çështje dua të theksoj se të pandehurin dhe mbrojtësin e tij me shkresa të lëndës i ka pajisur prokurori i shtetit ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 209 të KPPRK-së, e cila seancë dëgjimore ka zgjatur as sa ka qenë e nevojshme dhe deri sa palët kanë përfunduar deklaratimet e tyre, sikurse edhe në seancën ndaj të pandehurit I.V. e cila ka zgjatur po ashtu deri sa palët kanë përfunduar të gjitha deklaratimet e tyre. Ndërsa sa i përket caktimit të masës së sigurisë ndaj personit të cilit pretendon ankuesi, është në kompetencën e gjyqtarit të procedurës paraprahe i cili duhet të vlerësoj dhe të shqiptoj njëjërën nga masat për të cilat vlerëson se është adekuate për secilin rast konkret.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese, e po ashtu edhe shkresave tjera në dispozicion ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit S.K.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda ka parashtruar kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit PP/I.nr.200/22 të datës 04.07.2023, kundër të pandehurit I.V. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer dy vepra penale fajdeja nga neni 331 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së. Gjyqtari i procedurës paraprahe S.K., me datë 05.07.2023 duke filluar në ora 10:00 ka mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së prokurorisë për caktimin e masës së paraburgimit.

Në procesverbalin e seancës dëgjimore në faqe 6 (gjashtë) është konstatuar kërkesa e avokatit A.K., i cili ka kërkuar nga gjykata ti dorëzohen provat të cilat janë të cekura në shtojcën e kërkesës për caktimin e paraburgimit.

Lidhur me këtë kërkesë, gjyqtari i procedurës paraprahe S.K., para vendosjes ka kërkuar mendimin e prokurorit të shtetit, i cili mendim - deklarami është konstatuar në procesverbal, se në këtë fazë të procedurës penale provat nuk mund të dorëzohen mbrojtjes e as të pandehurit pasi që dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve ka të dhëna edhe për të pandehur tjerë, dhe pas këtij deklarimi gjyqtari i procedurës paraprahe ka marr Aktvendim procedural me të cilën është refuzuar

kërkesa e avokatit mbrojtës A.K. që të njëjtit të i dorëzohen provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë potencuar në shtojcën e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit dhe se pas kësaj seanca dëgjimore ka vazhduar me deklarimin e mbrojtësit lidhur me kërkesën e prokurorit të shtetit.¹

Andaj, pretendimi i ankuesit se gjyqtari i procedurës paraprake ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të pandehurit që të pajisen me provat përcjellëse të listuara në kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e masës së paraburgimit dhe si përfundim këto veprime paraqesin diskriminim dhe trajtim jo të drejtë të pandehurit në procedurë dhe si të tilla konsistojnë në shkelje disiplinore, janë të pabazuara, ngase gjyqtari një kërkesë të tillë të mbrojtësit e ka konstatuar në procesverbalin e seancës dëgjimore, pastaj përpara se i njëjti të vendos ka marrë mendimin edhe të prokurorit të shtetit, dhe pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit, duke ua dhënë mundësinë të gjitha palëve për tu deklaruar i njëjti, ka marr aktvendim procedural duke vendosur dhe refuzuar kërkesën e avokatit mbrojtës, e si të tilla veprime këto që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi të tija si gjyqtar dhe nuk cenojnë parimin e trajtimit në mënyrë të barabartë të palëve në procedurë.

Për më tepër avokati mbrojtës pas marrjes dhe pranimit të aktvendimit 2023:146869 të datës 05.07.2023, ka pasur të drejtën e tij për ta ankimuar këtë aktvendim në Gjykatën e Apelit të Kosovës ngase për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike nga ana e gjyqtarit gjatë punës së tij, mund të jenë shkak apo arsye për ushtrimin e mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike në gjykatat me të larta nga pala e pakënaqur, por nuk mund të konsiderohen shkelje disiplinore.

Po ashtu edhe pretendimi tjetër i ankuesit, se gjyqtari S.K. në njërin rast të kohëve të fundit, të karakterit të njëjte seanca dëgjimore ka zgjatur 9 (nëntë) orë, duke e liruar të pandehurin e dyshuar për tri vepra penale në procedurë të rregullt, ndërsa i njëjti gjyqtar në rastin konkret seancën dëgjimore në fjalë arrin ta përfundoj për afërsisht 1 (një) një orë, është pretendim i pabazuar pasi që kohëzgjatja e seancave dëgjimore varet nga specifikat dhe volumi i çështjeve, duke mos ua mohuar dhe kufizuar të drejtën palëve për tu deklaruar lidhur me pretendimet e tyre, e që në rastin konkret seanca dëgjimore e datës 05.07.2023 për shqyrtimin e kërkesës së prokurorisë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit I.V., ka filluar në ora 10:00 dhe ka përfunduar në ora 11:00, duke u përmbyllur me deklarimin e vetë të pandehurit

¹ Shih procesverbalin e seancës dëgjimore datë 05.07.2023, faqe 6.

drejtpërdrejtë në procesverbal dhe me konstatimin se “*meqë nuk ka asgjë tjetër për të shtuar seanca dëgjimore përfundon*”, konstatim që nënkupton se gjatë seancës dëgjimore të gjitha palët kanë pasur në dispozicion kohën e tyre të pakufizuar nga gjykata për tu deklaruar lidhur me pretendimet e tyre.

Ndërsa sa i përket mënyrës së vendosjes nga ana e gjyqtarit (*pretendimi i ankuesit se gjyqtari në një rast të karakterit të njëjtë, duke e liruar të pandehurin në procedurë të rregullt, i dyshuar për tri vepra penale, ndërsa të pandehurve tjerë u ka caktuar masën e paraburgimit të dyshuar për nga një vepër penale*), autoriteti kompetent vë në pah se gjyqtarët në punën e tyre janë të pavarur dhe vendosin sipas provave dhe fakteve të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe sipas ligjeve në fuqi, dhe askush nuk ka të drejtën e komentimit dhe vlerësimit të vendimeve gjyqësore, sepse të drejtën e vlerësimit të ligjshmërisë së një vendimi gjyqësor e kanë gjykatat e instancave më të larta.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit S.K., nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, AD/GJTHFR.8/2023, datë 24 gusht 2023

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

Avokat A.K. nga Prishtina - Parashtrues i ankesës

S.K. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës